

SPORTET GJUHHA E BOTES



Tabela e Përmbajtjes

HYRJJE	3
Pse Sport?	3
THEMELET BIBLIKE	4
Parimi I Lirisë	4
Parimi Larmisë Hyjnore	4
Parimi I Heshtjes	4
Parimi ose Dhuntia Njerëzore	4
PYETJE QË BËHEN MË SHPESH	6
A është mire për një besimtar të përfshihet në aktivitete sportive dhe në aktivitete argëtuese?	6
Mendoja se Bibla thotë se ushtrimet/ aktivitetet fizike nuk kanë vlerë. A është e vërtetë?	7
A duhet që cdo kishë të ketë shërbesë me sportët?	7
Si e fillon kisha një shërbesë me sportin?	7
PLANI	8
CFARË ËSHTË PIRAMIDA E SHËRBESËS ME SPORTET	9
CELËSAT DREJT SUKSESIT	10
SHËRBESA ME SPORTET DHE KISHA	11
AKTIVITETE TË SHËRBESËS SPORTIVE	12
KONTAKTE	12

“A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton cmimin? Vraponi në mënyre që ta merrni. Dhe kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha; dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që priset, kurse ne për një kurorë që nuk priset.

-Apostel Pali-
(1 Korintasve 9:24&25)

SPORT DHE SHËRBESË

HYRJE

Pse Sport?

Bota flet shumë gjuhë, por ka vetëm një gjuhë të përbashkët. ... gjuha e sportit dhe argëtimit. Asgjë tjetër më shumë sesa gjuha e sportit, nuk bashkon një komunitet... një vend dhe një botë. Në Izrael dhe Palestinë shumë njerëz nga të gjithë moshat shikojnë, lexojnë ose marrin pjesë në aktivitete sportive rregullisht çdo javë. Ndoshta gjatë kampionateve, ju keni parë ekrane gjigande që janë vendosur në vende publike ose sheshe qytetesh në mënyrë të tillë që njerëzit të bashkohen për të bërë tifozëllëk për skuadrën e tyre. Ose a keni qënë ndonjëherë mbrëmjeve në ndonjë fushë ose pallat sporti në komunitetin tuaj ku ka grupe njerëzish që shikojnë futboll, basketboll, volejball, atletikë, ngjitje në mur ose kullë, patinazh ose kërcim mbi trampolinë. Dy sporte më të njohura në Izrael janë futboll dhe basketboll. Gjithashtu sporte të tjera si noti, surfing, sporti i velave, ski në ujë... janë shumë të njohura gjatë muajve më të ngrohtë. Panvarësisht se ku jetoni, nuk duhet të shkoni larg për të parë dike që merr pjesë në një aktivitet sportiv.

E kuptoni se nëse përdorni aktivitetet sportive, ju po përdorni një nga mjetet më të mira për ta arritur këtë botë me dashurinë e Perëndisë? Meqënëse shumë njerëz shikojnë ose janë të përfshirë në sporte dhe aktivitete argëtuese, këto janë mjetet që duhet të përdorim për t'ia prezantuar ungjillin botës. Si në Kubë ku luhet bejsboll, apo në Rumani ku luhet shah, apo në Lituanë ku luhet futboll, ose në Sllovaki ku luhet basketboll, shumë njerëz e kanë njohur dashurinë e Perëndisë dhe kanë pranuar Jezusin përmes marrëdhënieve që janë ndërtuar me anë të sporteve!

Dhe përsëri, në shumë pjesë të botës dhe në shumë kisha, sportet dhe aktivitetet argëtuese shikohen si aktivitete të botës dhe madje mëkatore dhe humbje kohe. Unë mund ta kundërshtoja këtë opinion me anë ideve të mia, por në çdo gjë, përfshi edhe mënyrën sesi i përdorim sportet, bazat që tregojnë se çfarë duhet të bëjmë, janë tek Fjala e Perëndisë. Për këtë arsye le të shikojmë shkrimet për fituar një botëkuptim më të gjerë. Do të eksplorojmë katër parime.

THEMELET BIBLIKE

Parimi I Lirisë

Shumë gjëra në jetë nuk janë të mira ose të këqija. Ato janë neutrale. Shpesh ajo që e bën diçka të mire ose të keqe përcaktohet nga mënyra sesi e përdorim dhe/ose me qëndrimin që e përdorim. Për shembull kemi parasysh televizorin, filmat, internetin, paratë dhe pa dyshim, sportet. Tek 1 Kor 9, Pali shfaqet si mbrojtësi i lirisë. Ai nuk po thotë se ishte i lirë të bënte atë që dëshironte apo se ishte i lirë të bënte çdo gjë që është e padrejtë, ai po thotë se ishte i lirë nga çdo lloj sjellje ligjore ose rregullave të bëra nga njeriu nëse ato pengojnë shpalljen e ungjillit. 1 Kor 9:23 thotë, “dhe unë do të bëjë çdo gjë për hir të ungjillit ...” Kjo ishte dëshira e Palit. Pali po thoshte se ai ishte i gatshëm ti përshtatej një kulture edhe sikur kjo do të thoshte që ai do të përshtatej me një kulture tjetër në kurriz të kulturës së vet. Nëse Pali do të ishte i gjallë sot, do të ishte një muzikant atletik ose atlet muzikant sepse ato janë dy gjuhët universale të botës që do ti jepnin atij mundësi për të hyrë më lehtë në marrëdhënie me njerëzit për të shpallur Jezus Krishtin.

Parimi Larmisë Hyjnore

Perëndia i Biblës është i mahnitshëm, një Zot me shumë tipare. Ai është i larmishëm në thelb (Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë). Ai është i larmishëm në karakterin e Tij. Ai është i larmishëm në shërbesën e tij. Gjithashtu do ta shikojmë këtë qartë ndërsa do të zbulojmë më shumë rreth emrave të Perëndisë (shiko Appendix #1).

Thelbi është që Perëndia ynë madhështor punon në shumë mënyra. Në të njëjtën mënyrë, Perëndia na lejon të jemi krijuar (të përdorim sportet) për të arritur të tjerët për Krishtin.

Parimi I Heshtjes

Edhe pse nuk është shkruar në ndonjë vend në Bibël se mund ose nuk mund të përdorim sportet ose aktivitetet argëtuese, qëndrimi se Bibla është e heshtur, është një arsye/argument për ti përdorur ato. Nëse do të merremi me çështjen e heshtjes, duhet të bëhet një pyetje “kush e ka shkruar biblën?”. Duke përdorur shkrimin për tui përgjigjur pyetjes, përgjigja është – patjetër që e shkroi Perëndia (2 Timoteu 3:16 dhe 2 Pjetri 1:21). Kjo pastaj na çon tek pyetja e dytë, kjo ka të bëjë me karakterin e Perëndisë. “A është Zoti i shenjtë?” dhe përgjigja është e qartë “Po”. Konkluzioni është: Perëndia i shenjtë nuk do të kishte përdorur sportet ose atletikën si një metaforë për jetën e krishterë nëse këto të fundit do të ishin të gabuara. Edhe pse Bibla është e heshtur, përdorimi i sporteve si metaforë na tregon qartë se Perëndia nuk kishte asnjë kundërshtim ndaj aktiviteteve sportive. (shiko Hebrejët 2:1-3, 1 Kor 9:24-25, 2 Timoteu 2:1-5).

Parimi ose Dhuntia Njerëzore

Tek Psalmi 139, psalmisti lavdëron Perëndinë për faktin që Ai është Perëndia i gjithëpushtetshëm – aq i gjithëpushtetshëm sa Ai ishte i përfshirë personalisht në lindjen e tij (v. 13). Psalmisti deklaroi që Perëndia e ka krijuar atë si një qenie shpirtërore (“pjesët e brendshme”) dhe qenie fizike (“konturet”) dhe se puna e Perëndisë ishte e kujdeshme dhe e menduar mire (“i krijuar me mjeshtëri”- e përkthyer fjalë për fjalë “i thurur me delikatesë”). Nënkuptimi është që Perëndia e ka bërë çdo person ashtu siç donte dhe që ky krijim është “i bërë në mënyrë të mrekullueshme dhe me drujtje”.

Perëndia gjithashtu ka bekuar çdo njeri me aftësi të veçanta fizike, dhe/ose mjeshtëri. Dhe që çdo person merr pjesë në ndërtimin e mbretërisë, kur këto aftësi, mjeshtëri dhe dhunti përdoren për të shpallur Jezus Krishtin. Që do të thotë se kur një solist këndon, ose kur pastori predikon, ose kur atleti përdor pistën e vrapimit për të shërbyer Perëndisë, secili po përmbush vullnetin e Perëndisë sipas pjesës që I takon në qëllimet e mbretërisë. Nëse nuk e përdorim atë që Perëndia na ka dhënë përmes krijimit, ne mohojmë rendin dhe sovranitetin e Perëndisë.

Konkluzioni

Ka shumë parime të tjera që mund të përfshihen si pjesë të këtij studimi. Këto pak që përmendëm, do tju japin një themel të mirë për bazat Biblike për shërbesën e sporteve ose aktiviteteve argëtuese. Lutja ime është që do ti mbani në zemër dhe do ti konsideroni për të zbuluar se çfarë do të bëni ju ose bashkësia juaj për të përdorur sportet në ndarjen e ungjillit. Ne e dime se Perëndia dëshiron që “askush të mos humbasë”, por që të gjithë duhet të pendohen (2 Pjetër 3:9). E vetmja mënyrë që disa njerëz mund të dëgjojnë për dashurinë e Perëndisë është përmes jush dhe përmes mundësisë që keni për të patur një marrëdhënie me ta ndërsa shikoni dhe/ose luani sporte së bashku. Kur ne përdorim sportet, mund të përdorim një lojë, por nuk po luajmë një lojë. Përjetësia është në rrezik.. prandaj LUANI!!!

PYETJE QE BEHEN ME SHPESH

Ndersa pranojme pikepamjet e ndryshme, fjala “sporte” (ne kombinim me fjalen “sherbese”) I referohet secilit dhe gjithë aktiviteteve te larmishme qe nga loja e thjeshte deri tek sportet e organizuara konkurruese. Do te perfshinte lojera, aktivite argëtuese, aktivite ne terren te hapur, gjimnastike, fitness, sporte individuale dhe ne skuader, dhe aktivite ose garat me pjesemarrje te gjere. Sportet perfshijne gjinite e ndryshme, moshat e ndryshme, aftesi te ndryshme, po ashtu edhe shumellojshmeri te intensitetit dhe aktiviteve qe zhvillohen.

Fjala “sherbese” ka nje kuptim te Dhiates se Vjeter dhe nje kuptim te Dhiates se Re te shebeses dhe sherbimit: prandaj nje sherbese me sportet eshte nje aktivitet qe lejon veten te perdoret per t’i sherbyer Zotit, kishes (duke ndertuar besimtare), dhe jobesimtareve. Ne nuk duhet te mendojme asnjehere qe e kemi nje sherbese me sportet ne kishes thjesht sepse kemi aktivite sportive. Ne qellimisht I perdorim keto aktivite qe t’i japim lavdi Perendise, te ndihmojme besimtare te rriten, te arrijme me ungjillin te pashpetuarit dhe te gjitha keto se bashku perbejne “Sherbesen e Sporteve”.

A është mire për një besimtar të përfshihet në aktivite sportive dhe në aktivite argëtuese?

Nëse ku e bën këtë pyetje, ke në mendje pyetjen a dhunon aktiviteti sportiv një parim ose urdhërim të Perëndisë, atëherë përgjigja është : “jo” -nuk dhunon asnjë urdhërim të Perëndisë. Pas dyshim që ta thuash këtë gjë, duhet më pare të përkufizojmë fjalën “mëkat” dhe pastaj të zbulojmë nëse pjesëmarrja në aktivite sportive përfshihet në atë përkufizim. Fjala “mëkat” në Greqishten e vjetër, ishte një fjalë në fjalorin e shigjetarëve, fjalë për fjalë do të thotë “të mos qëllosh në shenjë”. Kur një shigjetar qëllon, ai synon “në zemër të shenjës”- në qendër të synimit. Kur shigjeta bie diku gjetkë, shigjetari “mëkato”- ai nuk qëllon në shenjë. Termi filloi të përdorej në botën e Krishterë, kur njerëzit filluan të mos qëllonin të shenjës- që ishte përsosmëria e caktuar nga Perëndia dhe urdhërimet e Tij të gjetura nëpër Shkrime. Me fjalë të tjera, kur bëj një jetë që është në kundërshtim me rregullat, këshillat dhe urdhërimet e Perëndisë (qenda e synuar), unë nuk kam “qëlluar në shenjë, kam mëkatuar”.

Kur je I përfshirë në një ngjarje sportive ose argëtuese, nuk është ngjarja ajo që do të përcaktojë nëse pjesëmarrësit kanë mëkatuar... mëkati do të jetë rezultati I motivit tim për të marrë pjesë, veprimet e mia ndërsa marr pjesë, ose qëndrimet e mia pas pjesëmarrjes. Një lojë nuk është mëkatore në vetvete. Megjithatë, nëse dikush merr pjesë me qëllimin për të rritur vlerat e vetes, ai ka mohuar vlerën që Perëndia ka vendosur brenda tij nëpërmjet sacrifices së Birit të Tij. Ky qëndrim është mëkat. Nëse pjesëmarrësi vepron në mënyrë të dhunshme ose flet në gjaknxehtësi e sipër gjatë lojës, nuk është loja që ka mëkatuar, pjesëmarrësi ka mëkatuar. Nëse pjesëmarrësi bëhet arrogant ose krenar për fitoren ose nevrkoset për humbjen, përsëri nuk është loja që ia ka shkaktuar këtë qëndrim, por si rezultat I lojës nxorri në pah një përgjigje të paperëndishme. Pjesëmarrësi ka mëkatuar. Për aq kohë sa pjesëmarrësi mund ruajë dëshminë e tij ose saj dhe ti sjellë lavdi Perëndisë përmes pjesëmarrjes (Kolozianët 3:23), asnjë besimtar nuk është i detyruar të shmangë aktivitetet sportive dhe ato argëtuese.

Mendoja se Bibla thotë se ushtrimet/ aktivitetet fizike nuk kanë vlerë. A është e vërtetë?

Gjenden disa interpretime të pasakta të 1 Tim 4:8, duke cituar se ky varg tregon se ne nuk duhet të përfshihemi në asnjë aktivitet fizik duke përfshirë këtu edhe aktivitetet sportive. Megjithatë, nuk është ky thelbi i këtij vargu.

Pali i shkruan Timoteut që po drejton një kishë në Efes; Efesi ndodhej në krah të Detit Aegan afër Greqisë- një vend që nderonte trupin përkundrejt shpirtit. Pali po përpiqet të ndihmojë Timoteun për të kuptuar dhe po i mësonte prioritetet e jetës. Kështu ai thotë tek vargu 7: “disiplino veten për perëndishmërinë”. Fjala “disiplinë” gjithashtu do të thotë stërvitje. Në vargun 8 Pali nuk thotë se ushtrimet fizike nuk kanë vlerë, madje ka një farë vlere. MEGJITHATË, ajo që ka vlerë më shumë është perëndishmëria- e cila gjithashtu vjen nga disiplinimi ose stërvitja. Prandaj, Pali do të inkurajonte të dyja llojet e stërvitjes, por stërvitja për perëndishmëri ka përparësi më shumë.

Pali do të binte në kontraditë me veten nëse do të paralajmëronte dikë për aktivitetet fizike dhe pastaj të na sfidonte të “merrim pjesë në garën e Krishterë”, si edhe të përkushtohim veten tone si një vrapues- që në fund të fundit, e gjithë jeta jonë të lavdëronte Perëndinë.

A duhet që cdo kishë të ketë shërbesë me sportet?

Jo, ashtu sic nuk është e nevojshme të kemi cdo shërbesë që kanë kishat e tjera ashtu është edhe me sportin. Arsyeja që duhet të na shtyjme të konsiderojmë të kemi një shërbesë të tillë është kur Zoti vendos një vizion në zemrat dhe mendjet e drejtuesve për këto shërbesë, kur Zoti ka përgatitur drejtues për këto shërbesë, ka njëzë me dhunti brenda kishës që kanë iu pelqejnë sportet dhe kuptojnë se si mund të përdoret sporti për të shërbyer qellimit të Perëndisë brenda kishës dhe kur disa rrethana të caktuara favorizojnë suksesin e kësaj shërbese (financa, drejtues, mjete etj).


Si e fillon kisha një shërbesë me sportin?

Pyetja e mësipërme identifikon disa çështje kritike ndërsa një kishë konsideron të fillojë një Shërbesë me Sportet: ato, plus të tjerat e ofruara këtu, paraqesin një proces të vijueshëm për të nisur:

1. Miratimi dhe përkrahja e shërbesës nga udhëheqësia e kishës (Pastori, Staf i drejtues)
2. Caktoni një udhëheqës vizionar (dhunti/talente specifike për këtë person do të përfshinte një zemër për të humburit dhe një dëshirë për t'i parë njerëzit të rriten në besimin e tyre, një njohuri për sportin, aftësi për rekrutim, aftësi mësimdhënëse me qëllim që të trajnojnë ata që janë rekrutuar dhe aftësi organizative dhe administrative me qëllim që të zbatojnë programet)
3. Caktoni një Koordinator Lutjeje dhe një Skuadër Lutjeje. Asgjë nuk do të arrihet e veçuar nga lutja!
4. Analizoni bashkësinë me qëllim që të identifikoni fushat e interesit për pjesëmarrje si dhe udhëheqje potenciale. Merrni në konsideratë përdorimin e Ngjarjeve Sfiduese Sportive që është diskutuar në këtë broshurë.
5. Vëzhgoni komunitetin me qëllim që të përcaktoni veprimtaritë, ngjarjet apo sportet me të cilat njerëzit janë të lidhur dhe identifikoni një Grup të Synuar.

6. Bazuar në analizën dhe vëzhgimin e bërë, konsideroni tri përcaktuesit kryesorë që një ngjarje apo veprimtari të ndodhë: FINANCAT, BAZA MATERIALE, PERSONELI – Udhëheqësit dhe Pjesëmarrësit.
7. Ndërtoni një program bazuar në informacionin nga #3-5.
8. Zhvilloni një strategji për ungjillizim dhe dishepullizim për çdo program të filluar
9. Organizoni dhe administroni programet. THJESHT DUHET BERE!
10. Vlerësoni dhe bëni modifikime ku është e nevojshme.

PLANI



Piramida e shërbesës së sportive

CFARE ESHTË PIRAMIDA E SHERBESËS ME SPORTET

Sherbesa ekziston për njerëzit. Ne duhet të kujtojmë që Jezusi ndërtoi marrëdhënie dhe punoi me individë, jo programe. Ndikimi ynë do të matet nga gjurmët që kemi lënë në jetë e njerëzve, sa i kemi ndihmuar të ecin dhe rriten në marrëdhënien e tyre me Zotin dhe jo thjesht programe interesante.

Howard Hendricks tha: “Çfarë po bëj unë sot që të garantojë ndikimin tim në brezat e ardhshëm? Nëse e kuptoj siç duhet Dhiatën e Re dy janë gjërat që Perëndia do të marrë nga ky planet.

Njëra është Fjala e Tij, dhe tjetra, njerëzit e Tij. Nëse ti po investon në ndërtimin e njerëzve së brendshmi mund të jesh i sigurt që kjo do të zgjase në përjetësi... Dishepullizimi është një sherbesë shumëfishimi. Sa herë që ndërton në jetën e një personi tjetër ti nis një proces që nuk do të perfundojë asnjëherë” Njerëzit, marrëdhëniet me ta, të ndërtosh në jetët e tyre, këtu e ka vendin edhe sherbesa me sportet.

Nepermjet sherbesës me sportet ne mund të jemi të qëllimshëm për të zhvilluar dishepuj dhe drejtues të ardhshëm për Krishtin. Në sherbesë është e lehtë të humbasësh fokusin, dhe të mos përmbushësh gjithë çfarë Zoti do për ne. Po ashtu edhe sherbesa e sporteve mund të bëhet thjesht një seri aktivitësh zbavitëse nëse nuk jemi të fokusuar tek qëllimi ynë dhe nuk kemi një plan se si të bëjmë përfshijmë në jetën e kishës ata që kanë ardhur tek Krishti. Kjo piramidë tregon se si sherbesa me sportet e përmbush këto mision të kishës dhe si ndihmon të mbajmë një fokus dhe vizione të qarta në planifikimin dhe zbatimin e çdo sherbesë me sportet. Si përfundim ne si besimtarë jemi në proces rritjeje dhe formimi të vazhdueshëm për t’u bërë me shumë si Jezus Krishti (Filipianëve 1:6).

Ky cikël ripërsëritet ndërkohë që drejtuesit janë trajnuar dhe zhvilluar dhe vazhdojnë të trajnojnë të tjerë për të qenë drejtues të sherbesave të tilla në kisha ose dege të tjera të kishës së tyre.

NIVELI – FITO

Ky nivel rrotullohet rreth gjithë njerëzve në përgjithësi, kushdo që është brenda zonës së gjeografike ku mund të influencojmë. Programe, aktivitete, projekte të mëdha ungjillzuese. I vetmi përkushtim që kërkohet nga pjesëmarrësit është pjesëmarrja në këto aktivitete ose pranim i literaturës së shpërndarë. Qëllimi i kësaj sherbesë është dëshira të duhet etë jete që kjo sherbesë të jete e pranishme në komunitet. **Bashkësia/Miqësia** dhe **Ungjillizimi**

NIVELI – NDERTO

Ky nivel rrotullohet rreth atyre që ia kanë kushtuar jetët e tyre Krishtit po ashtu edhe rreth atyre që duan të zhvillohen dhe rriten në marrëdhënien e tyre me Jezusin. Përkushtim dhe disiplinë janë ato që kërkohen në çdo program në këtë nivel. Këtu fillon edhe puna me ata persona që janë identifikuar nga niveli I parë –Fito. Numrat nuk janë ato që kanë rendesi. Në mënyrë që një person të jete pjesë e këtij niveli ai/ajo duhet të jete BGM – besnik, i gatshëm, dhe i mesueshëm.

Rritja shpirtërore dhe dishepullizimi bëhet me qëllim që pjesëmarrësit të përgatiten për jetë dhe për sherbesë.

Shembuj programesh: Grupet qelizore ose familjet biblike, skuadrat, Studimet e Biblës, programe të ndryshme trajnimi drejtuesish, kurset Alfa për sportet etj.

NIVELI – DERGO

Synon te zgjeroje zhvillimin shpirtëror te personit/shebese duke i dhene nje vision per tju sherbyer te tjereve dhe duke siguruar mundesi per zbatim praktik. Per te arritur ne kete nivel personi eshte trajnuar dhe ka pasur mundesine te sherbeje si drejtues. Nje sherbese ne kete nivel duhet te tregoje rritje dhe nje gatishmeri per te filluar nje sherbese ne nje vend tjetër. Gjithashtu ne nivelin dergo kjo sherbese mund te pregatise/dishepullizoje besimtarët e rinj qe po i bashkangjiten kishes.

CELËSAT DREJT SUKSESIT

Ndërsa filloni, ja disa gjëra që duhet të kini parasysh:

1. LUTUNII!!
2. Fillo me NIVELIN FITO. Identifiko zonën tënde të synuar, më pas PLANIFIKO. Zgjidh një ngjarje/veprimtari/ dhe bëje atë mirë. Njerëzve u pëlqen të marrin pjesë në diçka që duket e organizuar dhe është profesionale gjithashtu.
3. Filloje me pak. Shtriji këmbët sa ke jorganin.
4. Zgjerohuni gradualisht. Ndërsa zhvilloni udhëheqës, pjesëmarrës dhe një prani në komunitet, më pas ecni përpara.
5. Qëndrojuani besnik synimeve tuaja. Punoni për të zhvilluar njerëz. Krijoni bashkëmiqësi për besimtarët dhe shoqëri për jobesimtarët: ndani besimin tuaj, dishepullizoni dhe përfshijini ata që reagojnë pozitivisht, por që janë gjithashtu gati të 'krasiten'. Nëse ndonjë veprimtari apo ngjarje nuk po jep fryt, krasite atë (hiqe jashtë). Qëllimi i krasitjes është të shkaktojë frytshmëri më të madhe.

Nga Church Sports International. Përdorim i lejuar.. Për më shumë informacion shiko:

www.churchsports.org

SHERBESA ME SPORTET dhe KISHA

Misioni i Kishes eshte te synoje:

LART NE ADHURIM
(drejt Perendise)

BRENDA PER RRRITJE
(Ne njeriun e brendshem)

JASHTE PER UNGJILLIZIM
(jobesimtaret per Krishtin)

Misioni i Sherbeses me Sportet

Qe te jete perkrah kishes duke e ndihmuar ate ne permbushjen e misionit te dhene nga Zotit per nje jete ne adhurim, dishepullizim, dhe ungjillizimin e botes.....per t'i sherbyer kishes duke qene perkrah nepermjet mundesive qe sportet sigurojne per

BASHKESI & MIQESI

*Besimtar me besimtar (Heb 10:24; Vep e Apostujve 2:42; Gal 6:2)

*Besimtar me jobesimtar (1 Kor 9:22; Mat 5:16; 2 Kor 5:20)

UNGJILLIZIM

*Duke jetuar sipas Lajmit te Mire (Gjon 14:27; Efes 4:32; Gjon 13:35)

*Duke ndare Ungjillin, Lajmin e Mire (Mark 16:15; Vep 10:42; 2 Kor 5:18)

DISHEPULLIZIMI

*Te themeluar ne Jezusin (Efes 4:12,13; 2 Pje 3:18; Rom 13:14)

*Duke u rritur ne Jezusin (Rom 8:29; Gjon 3:3; Filip 1:6)

INTEGRIMI

*Perfshirja ne bashkesi e besimatreve te rinj (Mat 22:9; Mat 5:13-16; 1 Pje 3:8,9)

*Bashkimi me Trupin e Krishtit (Efes 1:13; 1 Kor 12:13,14; Rom 11)

Si e ndihmon sherbesa me sportet kishen

1. Lehteson/ndihmon misionin ne kisha
2. Sherbetore te sherbeses
3. Partnere per Porosine e Madhe se Perendise.
4. Sherbejme si 1 trup me dhunti te ndryshme
5. Ure e pershtatshme kulturore
6. Mjet i mire per ungjillizim
7. Nivel hyrje per sherbese
8. Pregatitja e drejtuesve
9. Mjet per permbushjen e thirrjes
10. Siguron nje ambjent zhvillimi
11. Inkurajon venie ne praktike te besimit
12. Eshte efektive



AKTIVITETE TË SHËRBESËS SPORTIVE

Sporte me skuadra konkurruese -Basketball, baseball/softball, football, volejball, hokei, etj.

Sporte me konkurim individual - Badminton, golf, tenis, pingpong, triathlon/vrapime, track & field

Ngjarje – aktivitete sportive, 10K or Fun Runs, Lojëra për fëmijë, piknik, aktivitete nëpër fusha, ngjarje sportive për ungjillizim (Kupa e Botës, lojëra olimpike, ture me lojëra ose aktivitete sportive, etj)

Aktivitete Argëtuese - Art & punëdore, lojëra në tabela, drama, muzikë

Aktivitete në natyrë: kampe, peshkim, çiklizëm

Aktivitete për të moshuarit- Ecje, ushtrime/programe për tërheqje muskujsh, noti.

Aktivitete për mirëqënien fizike- aeroabi/ushtrime, mësim për kontrollimin e peshës dhe të ushqyerit.

Aktivitete për Ungjillizim- Liga, skuadra të shërbesës së burgut, aktivitete sportive,

Argëtime sociale- Ballo kërcimi, piknike, vakte së bashku, nata e filmit etj.

Programe të Veçanta- Pushime sportive të shkollës së Biblës, Programe për personat me aftësi të kufizuar.

Të tjera - ????. Ti je i kufizuar vetëm nga krijmtaria jote.

KONTAKTE

Për më shumë informacion sesi të filloni të përdorni sporte në kishën tuaj kontaktoni:

Athletes in Action
Atoomweg 10-2
9743 AK Groningen
The Netherlands
www.athletesinaction.nl
Email: j.detweiler@athletesinaction.nl
(31) 50-549-2715

Church Sports International
2084 Caravelle Ct.
Lincoln, CA 95648
USA
(01) 916-543-2033
www.churchsports.org
Email: roswald@churchsports.org